

STRUKTURA E QSU “NËNË TEREZA”

Struktura e QSU "Nënë Tereza" përbëhet nga gjithsej 3,221 punonjës, të shpërndarë sipas kategorive :

1. Administrata, e cila përfshin një total prej 346 punonjësish, të angazhuar në funksione drejtuese, administrative dhe mbështetëse të institucionit;
2. Polet e Administrimit të Integruar, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të strukturës organizative me gjithsej 2,875 punonjës, të angazhuar drejtpërdrejt në ofrimin dhe mbështetjen e shërbimeve shëndetësore.

Në mënyrë të detajuar, personeli në Polet e Administrimit të Integruar është si vijon:

- Trupa mjekësore përbëhet nga 381 mjekë, të cilët kontribuojnë në ofrimin e shërbimeve diagnostikuese, terapeutike dhe akademike të mbështetur nga një kontingjent prej 400 mjekësh specializantë;
- Personeli teknik i shkencave mjekësore përfaqëson kategorinë me numrin më të lartë të punonjësve, me gjithsej 1,469 punonjës. Në këtë kategori bëjnë pjesë infermierë, përfshirë personelin e Task Force dhe logopedistët, si dhe teknikë imazherie, fizioterapistë, laborantë etj;
- Kategori të tjera të shërbimeve mbështetëse përbëhen nga 625 punonjës, të cilët kontribuojnë në garantimin e funksionimit të pandërprerë të shërbimeve të institucionit.